

VENDIM
Nr. 246, datë 21.12.2020

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, NË LIDHJE ME KËRKESËN E SHOQËRISË “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Nisur nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 53, pika 3, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135/15 prot., datë 17.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë ‘Greentech Energy Systems’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Greentech Energy Systems” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1156 prot., datë 2.11.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC Pishat, me vendndodhje në përroin e Holtës, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan.

- Po ashtu, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 184, datë 13.11.2020, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Pishat” me kapacitet të instaluar 1991 kw, për një afat 30-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën me nr. 62/37 prot., datë 16.11.2020, për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 1155/1 prot., datë 24.11.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoj plotësimin e dokumentacionit të munguar nga aplikimi i saj.

Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1155/2 prot., datë 17.12.2020, shoqëria ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit për plotësimin e dokumentacionit, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19.

- Në nenin 14, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, përcaktohet se për centralet e lidhura drejtpërdrejtë me rrjetin e shpërndarjes, dhe për të gjitha licencat e tjera Bordi merr vendim jo më vonë se 30 ditë pune nga data e publikimit të parë të njoftimit në shtyp, për aplikimin në shtyp, ndaj për kërkesën e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k., Bordi duhet të marrë vendimin përfundimtar brenda datës 31.12.2020.

- Në nenin 53, pika 3, të “Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se:

“3. Afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

- Kërkesa e shoqërisë për zgjatje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës është bërë përpara mbarimit të afatit për vendimmarrjen përfundimtare të Bordit të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 ditë punë afatin e vendimmarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti